

KOMUNA E RAHOVECIT

JANAR - MARS 2025

RAPORT TREMUJOR I PUNËS DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

[illegible]

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME.....	2
SFIDA DHE REKOMANDIME.....	3
STATISTIKA – GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË HYRAVE.....	4
PËRFUNDIM.....	5

PËRMBLEDHJE E PËRSGJITHSHME

Drejtoria për Punë Inspektuese në Komunën e Rahovecit ka për detyrë kryesore mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve komunale, me qëllim të sigurimit të një mjedisi të rregullt dhe të sigurt për qytetarët. Ky raport tremujor përmbledh aktivitetet dhe arritjet kryesore të drejtorisë gjatë periudhës janar - mars 2025, duke u fokusuar në sektorët kyq si ndërtimi, mjedisi, gëshjet komunale, tregu dhe transporti publik.

1. Sektori i Ndërtimit

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, inspektorët e ndërtimit kanë kryer 63 inspektime dhe ri-inspektime të objekteve ndërtimore të kategorisë së parë. Këto inspektime përfshinin verifikimin e dokumentacionit teknik, përfshirë projektet e ndërtimit dhe lejet përkatëse. Si rezultat, janë shqiptuar 23 gjoba mandatore për ndërtim pa leje. Nga këto raste, 4 subjekte janë pajisur me leje ndërtimore, 32 prej tyre kanë aplikuar kushte ndërtimore, 23 kërkesa janë aprovuar 8 janë në shqyrtim dhe 1 është refuzuar. Përvëç kësaj, janë lëshuar vendime për ndërprenj e punimeve ndërtimore deri në evitimin e parregullsisive tekniko-procedurale.

2. Sektori i Mjedisit

Inspektorët i mjedisit ka realizuar inspektime gjatë kësaj periudhe, duke u fokusuar në kontrollin dhe mbrojtjen e mjedisit. Janë shqiptuar 33 gjoba mandatore për ndotje të mjedisit. Gjithashtu, janë inspektuar 11 biznese që ushtrojnë aktivitete të dëmshme për mjedisin, duke kërkuar pajisjen e tyre me leje mjedisore. Si rezultat, 8 prej tyre kanë aplikuar për leje mjedisore, 6 janë pajisur me leje, 1 është refuzuar dhe 1 është gjobitur për mungesë të lejes mjedisore komunale.

3. Sektori i Gëshjeve Komunale

Drejtoria ka trajtuar një numër të madh kërkesash nga qytetarët, kryesisht lidhur me problemet në rrjetin e kanalizimit dhe gëshjeve infrastrukturorë. Inspektorët kanë ndërmarrë veprimet për zgjidhjen e këtyre problemeve, duke siguruar që infrastrukturë komunale të jetë funksionale dhe në përputhje me standardet. Janë shqiptuar 9 gjoba dhe janë marrë masa kundër shkeljeve të rregullave për përdorimin e hapësirave publike. Gjithashtu, janë lëshuar 21 aktvendime kundrejt KRU Gjakova për të siguruar zhvillimin e aktivitetëve në mënyrë ligjore dhe të kontrolluar. Për më tepër, 35 shfrytëzuesve të hapësirave publike para lokaleve afariste u janë shpërndarë urdhëresa për t'u pajisur me lejet përkatëse;

SFIDA DHE REKOMANDIME

Sfida:

- Mungesa e bashkëpunimit të disa bizneseve dhe qytetarëve për t'u pajisur me dokumentet e nevojshme;
- Ndërtimi pa leje dhe mungesa e respektimit të kushteve të ndërtimit.

Rekomandime:

- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional për një zbatim më efikas të ligjit;
- Edukimi i qytetarëve dhe bizneseve për rëndësinë e përmbushjes së kushteve ligjore;
- Angazhimi i inspektorëve dhe rritja e kapaciteteve për të monitoruar dhe zgjidhur problemet infrastrukturore;

6. Bashkëpunimi me institucionet e Tjera

Drejtoria ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës, Gjykatat dhe organet e tjera të administratës për të siguruar zbatimin e ligjit dhe rregullave në fushat përkatëse. Ky bashkëpunim ka qenë esencial për adresimin e shkeljeve dhe sigurimin e një mjedisi të sigurt dhe të rregullt për qytetarët.

5. Sektori i Transportit Publik dhe Komunikacionit

Në sektorin e transportit publik, inspektorët kanë mbikëqyrur kompanitë e licencuara për transportin e udhëtarëve, duke siguruar përmbushjen e kërkesave të rendit dhe sigurisë. Janë monitoruar linjat e autobusëve dhe janë urdhëruar autotaksitë për vazhdimin e lejeve për transportin e udhëtarëve, duke siguruar përmbushjen e kërkesave të rendit dhe sigurisë. Janë

Inspektorët e tregut kanë mbikëqyrur dhe kontrolluar bizneset dhe tregtarët për të siguruar ofrimin e produkteve të sigurt dhe respektimin e normave për gënimet dhe etiketimin. Janë realizuar inspektime në dyqane dhe markete, duke shqiptuar 2 gjoba mandatore për mungesë dokumentacioni dhe mospërpunje gëimesh. Gjithashtu, janë verifikuar peshoret në tregjet e bukës për të siguruar saktësinë e tyre. Në kuadër të luftës kundër ekonomisë informale, 22 biznese të reja janë regjistruar në zyrën e ARBK-së pas urdhërresave nga shërbimi ynë, dhe po atëherë janë lëshuar për subjektet afariste që kanë plotësuar kushtet higjienike-tekniqe.

4. Sektori i Tregut

- Përdorimi i teknologjive moderne për të përmirësuar mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit;

STATISTIKA – GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË
HYRAVE

LLOJI I NDËSHKIMIT	NUMRI I GJOBAVE TË SHQIPTUARA	VLERAT GJOBE NË €
GJOBA MANDATORE PËR NDËRTIM PA LEJE	23	4450€
GJOBA MANDATORE – ÇËSHITJE KOMUNALE	6	900€
GJOBA MANDATORE - TREGU	2	1000€
GJOBA MANDATORE PËR MJEDIS	33	1550€
TOTAL:	64	7900€

LLOJI I VEPRIMIT	NUMRI I KËRKESAVE	VLERAT NË €
KËRKESA PËR KONTROLL INSPEKTUES	7	70 €
PËLQIME PUNE	20	300€
TOTAL:	27	370€

TOTALI I TË HYRAVE NË DPI:	JANAR – MARS 2025	8270€
----------------------------	-------------------	-------

PERFUNDIM

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, Drejtoria për Punë Inspektuese e Komunës së Rahovecit ka demonstruar përkushtim dhe efikasitet në mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve komunale. Pavarësisht sfidave të hasura, përfshirë mungesën e bashkëpunimit nga disa subjekte dhe kufizimet në burime, drejtoria ka arritur të realizojë një numër të konsiderueshëm inspektimesh dhe të ndërmarre masa konkrete për përmirësimin e situatës në sektorët e ndërtimit, mjedisit, gëshjeve komunale, tregut dhe transportit publik. Rekomandohet që në të ardhmen të intensifikohet bashkëpunimi ndërinsistucional, të rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe bizneseve për rëndësinë e respektimit të ligjit, dhe të investohet në ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve për të adresuar sfidat e identifikuar dhe për të përmirësuar më tej shërbimet ndaj komunitetit.

Nora BOSHNIJAKU

